



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.08-214**  
**8.8.2025**  
**Shkup**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup>, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafët 17 dhe 18 dhe neni 75 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, pas zbatimit të Konkursit Publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, të publikuar në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik, PA1 nr.08-155 datë 8.5.2025 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 96/25 datë 14.5.2025), në pajtim me Raportin e vlerësimit të aplikacionit të paraqitur PA1 nr.08-214 datë 4.8.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3325/2 datë 7.8.2025, në seancën e 7-të mbajtur më 7.8.2025 miratoi si vijon:

**VENDIM**  
**për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor,**  
**në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit**

1. I JEPET(NDAHET) leja për transmetim në radio të shërbimit programor radio muzikore me format të specializuar, në të cilin muzika e transmetuar është kryesisht popullore (argëtuese), në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit, kandidati, personi juridik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup, me seli në bul. "Partizanski Odred" nr. 62 - lamela C/hyrja e ndërmjetme 1, komuna Karposh, Shkup. Shërbimi i programit në radio nga paragrafi (1) të kësaj pike do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AKE), përkatësisht: 105.3 MHz.
2. Leja për transmetim në radio në nivel lokal, e cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, jepet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër.
3. Pas pranimit të këtij Vendim për dhënien e lejes, kandidati në konkurs, personi juridik Shoqëria Tregtare Radiodifuzive BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi, duke qenë se është transmetues i përhershëm, duhet të regjistrojë shoqëri tregtare radiodifuzive të re në regjistrin përkatës, në pajtim me nenin 77, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

<sup>1</sup> Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: neni 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga kandidati në konkurs, personi juridik Shoqëria Tregtare Radiodifuzive BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup, së cilës i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi, do të paguajë kompensim vjetor në llogarinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit për leje përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të LSHMAAV dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.185/14), Rregullorja për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të programeve televizive dhe radio ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14).

**4.** AKE në bazë të lejes për transmetim në radio për shfrytëzim të radiofrekuencave do të japë miratim për shfrytëzim të radiofrekuencave në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike.

Për shfrytëzim të radiofrekuencave, paguhet kompensim vjetor në llogari të AKE për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzim të radiofrekuencave.

**5.** Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga kandidati në konkurs, personi juridik Shoqëria Tregtare Radiodifuzive BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup, së cilës i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi, detyrohet të fillojë me kryerje të veprimtarisë më 01.10.2025.

Në rast të mosrespektimit të afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë cituar në paragrafin 1 të kësaj pike të Vendimit, Agjencia do ta heqë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshihet transmetuesi nga regjistri i transmetuesve.

**6.** Personi juridik, cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, të cilit i është dhënë leja për transmetim në radio, është i detyruar plotësisht të përmbushë kushtet dhe kërkesat për të cilat është zotuar në Aplikim gjatë konkurimit.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje profesionale në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga skadimi i ditës së tridhjetë nga dita e fillimit me kryerje të veprimtarisë përcaktuar në lejen për transmetim në radio, me qëllim përcaktim të përmbushjes së kushteve teknike, në pajtim me lejen për transmetim në radio.

**7.** Për këtë Vendim me shkrim të njoftohet kandidati në Konkursin publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e Komunës së Shtipit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

**8.** Ky Vendim është përfundimtar dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

## **A r s y e t i m**

Në pajtim me nenin 69 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), për shërbimin programor të radios terestiale që transmetohet nëpërmjet resursi (burimi) të kufizuar siç janë radiofrekuencat, Agjencia e jep lejen për transmetim në radio përmes konkursi publik.

Agjencia, në pajtim me nenin 70 paragrafi (1) të LSHMAAV, miraton vendim për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim në radio, sipas detyrës zyrtare ose me pranim të kërkesës me shkrim nga pala e interesuar, në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzim të radiofrekuencave, si dhe në pajtim me Studimin, mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit të lartpërmendur.

Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit, PA1 nr.08-155 datë 8.5.2025. ("Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr.96/25 datë 14.5.2025), në bazë të kërkesës me shkrim për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit nga pala e interesuar, personi juridik Shoqëria Tregtare Radiodifuzive BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup (ark.nr 08-522/1 datë 3.2.2025), Njoftimi i dorëzuar nga AKE në lidhje me kërkesën për informacion për frekuenca të lira për transmetim të programit në radio në zonën e komunës së Shtipit, ark. nr.0805-376/2 datë 12.2.2025 (nr.y në ark.08-432/3 datë 24.2.2025), dhe në pajtim me Studimin e përgatitur për përcaktim të arsyeshmërisë për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit (ark.nr.03-1928/1 datë 29.4.2025).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve për pjesëmarrje në konkursin publik në fjalë ishte deri më 14.7.2025 përkatësisht kandidatët për konkurs duhet të paraqisnin aplikim në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, llogaritur nga dita e parë e ditës së publikimit të vendimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Deri më 14.7.2025 si (afati i fundit për dorëzim të aplikimeve), drejtuar Agjencisë u dorëzua 1 (një) Aplikim me dokumentacion shoqëruar për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit, më 14.7.2025 nga kandidati, personi juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup (PA1 nr.08-214).

Hapja publike e Aplikimit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publik nga kandidati i lartpërmendur u mbajt 1 (një) javë pas skadimit të afatit për paraqitjen e aplikimeve, përkatësisht më 22.7.2025, me ç'rast aplikimi i paraqitur u shqyrtua nga aspekti nëse është i rregullt, në kohë dhe i plotë, përkatësisht nëse i përmban të gjitha dokumentet e përcaktuara në nenin 73 paragrafi (3) të LSHMAAV, dhe që i referohen kandidatit - personit juridik, për të cilin është mbajtur Procesverbal nga hapja publike (PA1 nr.08-214 datë 22.7.2025)

Në periudhën nga data 23.7.2025 deri më 30.7.2025, nga sektorët kompetent të Agjencisë u vazhdua me vlerësim të Aplikimit të lëndës për konkurs publik (PA1 6p.08-214 datë 14.7.2025) paraqitur nga kandidati, personi juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup. Aplikimi i dorëzuar në afatin e përcaktuar është vlerësuar nga sektorët kompetent të Agjencisë, sipas kriterëve të vlerësimit përcaktuar në tabelën në pikën 5 të Vendimit PA1 nr.08-155 datë 8.5.2025 për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal. Sektori për çështje programore vlerësoi kriteret nga pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe pika 7 të tabelës Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit vlerësoi kriterin nga pika 5 e tabelës; Sektori për financa dhe logjistikë vlerësoi kriterin nga pika 9 e tabelës dhe Sektori për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme vlerësoi kriteret nga pika 6, pika 8 dhe pika 10 e tabelës, me ç'rast u konstatua se Aplikacioni PA1.08-214 datë 14.7.2025 nga kandidati, personi juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup është i rregullt dhe është vazhduar me vlerësim dhe pikëzimin e tij.

Kështu, Sektori për çështje programore (SÇP), në kontributin e dorëzuar më 29.7.2025, ka konstatuar se aplikimi i kandidatit – personit juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup, përmban të tre dokumente në aspektin programor. Më pas, sipas të dhënave të paraqitura, radioja i plotëson kushtet programore nga Dokumentacioni i Konkursit për radio muzikore me format të specializuar, në të cilën muzika e transmetuar është kryesisht popullore (argëtuese) dhe do të përfaqësohet me më shumë se 70%, e cila do ta transmetojë programin në gjuhën maqedonase (Koncepti Programor thotë se 97% nga totali i muzikës së transmetuar në baza javore do të jetë popullore (argëtuese), dhe 73% e muzikës së transmetuar do të jetë muzikë-pop). Pjesa folëse do të jetë 1.95% nga totali i programit të transmetuar gjatë një jave. Sipas Rregullores për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve, radio muzikore duhet të ketë deri në 5% përmbajtje folëse në javë. Gjithashtu, sipas të dhënave, programi dhe një pjesë e muzikës do të transmetohen në gjuhën maqedonase. SÇP theksoi se ka njëfarë mospërputhjeje midis të dhënave nga Koncepti i Programit dhe Skema e Programit, por se kjo nuk ndikon në përmbushjen e kërkesave të programit nga Dokumentacioni i Konkursit, pas së cilës vazhdoi me pikëzimin e Aplikimit, në: pikën 1 të tabelës - Përfaqësimi në programin e prodhuar nga vetë transmetuesi (in-hous produksion) gjatë javës, si arsyetim për përmbushjen e kriterit, ka cituar se përfaqësimi i parashikuar në programin e prodhuar nga vetë transmetuesi në pjesën folëse të programit, gjatë javës, është 100%, sa është dhe kohëzgjatja e pjesës folëse të programit ( 3 orë dhe 10 minuta); pika 2 e tabelës Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik

i përmbajtjes, si arsyetim për përmbushjen e kriterit, ka cituar se në pjesën folëse të programit është treguar se do të përfaqësohen 9 (nëntë) lloje programesh që përmbushin tre funksione mediatike ( funksion informues, edukativ, dhe argëtues); pika 3 e tabelës - Përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, si arsyetim për përmbushjen e kriterit, ka cituar se kandidati ka treguar në Konceptin programor se radio gjatë vitit do të transmeton 11 orë programe që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, dhe është planifikuar 30% nga totali i muzikës së transmetuar gjatë ditës të jetë muzikë instrumentale nga autorë maqedonas, muzikë vokale dhe/ose vokale instrumentale në gjuhën maqedonase; pika 4 e tabelës - Përfaqësimi i informacionit dhe përmbajtjes në pjesën holëse të programit me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës,

për këtë kriter është konstatuar se nuk është plotësuar, dhe prandaj nuk është pikëzuar, dhe si arsyetim për këtë, ka cituar se gjatë javës, në pjesën folëse të programit është parashikuar që transmetohet gjithësej 45 minuta informacion dhe përmbajtje me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjë që nuk plotëson minimumin për transmetim së paku 1 ore informacion me karakter lokal, që ishte përcaktuar në dokumentacionin e konkursit, dhe pika 7 e tabelës - Koha e ofruar e transmetimit ditor të programit, si arsyetim për përmbushjen e kriterit, u citua se çdo ditë është planifikuar të transmetohen 24 orë program.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit (SPSDA) në kontributin e dorëzuar më 30.7.2025, ka konstatuar se kandidati - personi juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup, plotëson kushtet minimale kadrovike, të cekur në pikën 5 të tabelës - Numri dhe struktura e të punësuarve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht plotëson kriterin të ketë së paku dy persona në marrëdhënie të rregullt pune që marrin pjesë në krijimin e programit, të punësuar nga transmetuesi me orar të plotë pune në pajtim me Ligjin për Marrëdhënie Pune dhe kryeredaktori i shërbimit programor të jetë në marrëdhënie të rregullt pune. Gjatë vlerësimit të Aplikimit, SPSDAkonstatoi se nuk është e qartë se sa persona do të punësohen nga transmetuesi, as në cilat vende të punës. Konkretisht, në Planin e Biznesit të paraqitur ndaj Aplikimit, në pjesën që lidhet me strukturën e planifikuar të stafit, është cekur se "Fillimisht, do të ketë një punonjës me kohë të plotë pune në marrëdhënie të rregullt pune, nga të cilët një i punësuar do të jetë kryeredaktor dhe redaktor muzike i shërbimit programor, punonjës mediatik me përvojë ALP, dhe i dyti do të jetë montazhier teknik me ALP." Nga ana tjetër, sipas të dhënave të cituara në Formularin nr. 4 – Numri dhe struktura e punonjësve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë në marrëdhënie të rregullt pune do të jetë vetëm një person, përkatësisht udhëheqës/drejtor. Duke qenë se ishte e qartë se kushti minimal për një personi në marrëdhënie të rregullt pune është plotësuar, më 24.7.2025, dhe në pajtim me nenin 75 paragrafi 2 të LSHMAAV, SPSDA kërkoi sqarime nga parashtruesi i Aplikimit në lidhje me numrin e personave dhe në cilat pozicione do të jenë në marrëdhënie të rregullt pune. Më 25.7.2025, parashtruesi i Aplikimit shpjegoi se "fillimisht, do të punësohet një person me kohë të plotë në marrëdhënie të rregullt pune i cili në të njëjtën kohë do të jetë udhëheqës dhe kryeredaktor." Nga aspekti i kufizimeve për fitimin e pronësisë dhe koncentrimin të paligjshëm mediatik, SPSDA konstatoi se nuk ka pengesa për dhënien e lejes. Parashtruesi i aplikimit ka leje për transmetim të programit në radio në nivel rajonal (në zonën e Shkupit), dhe Këshilli i Agjencisë, në seancën e 6-të mbajtur më 29.7.2025, miratoi vendim me të cilin këtij transmetuesi i ndahet leja për transmetim në radio në nivel lokal (në zonën e Prilepit). SHTR "Buba Mara" nuk paraqitet si themeluesi shoqërive të tjera tregtare. Në nenin 37, paragrafi 3 të LSHMAAV është konstatuar se "Person fizik ose juridik që është partner shumicë ose aksionar shumicë në transmetues që ka leje për të ofruar transmetim televiziv në nivel rajonal, si dhe person lidhur me një partner ose aksionar në transmetues që ka leje për të ofruar transmetim televiziv në nivel rajonal, mund të jetë partner shumicë ose aksionar shumicë së paku edhe një transmetues që ka leje për kryerje të veprimtarisë radiodifuzive për transmetim televiziv në nivel rajonal, ku zonat në nivel rajonal nuk janë fqinje dhe në më së shumti dy transmetues të tjerë që kanë leje për të ofruar transmetim televiziv në nivel lokal, ku zonat në nivel lokal nuk janë fqinje", në pajtim me paragrafit 6 nga neni i njëjtë, "Dispozitat e paragrafëve (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni zbatohen edhe për persona fizik ose juridik që është partner shumicë ose aksionar shumicë në transmetues që ka leje për të ofruar transmetim në radio"Personi fizik Ranko Petroviq paraqitet si themelues dhe udhëheqës i SHTR "Buba Mara" dhe si person i autorizuar i Shoqatës Qendra për aplikim të njohurive dhe

zhvillim kreativ "PRIMA CENTAR" Shkup (kjo shoqatë nuk paraqitet si themelues i personave të tjerë juridikë). Pronari i vërtetë i Aplikimit të parashtruar është personi fizik Ranko Petroviq.

Sektori për financa dhe logjistikë (SFL) në kontributin e dorëzuar më 23.7.2025 ka konstatuar se dokumentet e paraqitura nga personi juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup për konkursin për zonën e komunës së Shtipit, nga aspekti financiar janë të kompletuara. Si arsyetim për përmbushjen e kriterit nga pika 9 e tabelës - Garancitë e ofruara për aftësi financiare për të kryer veprimtarinë, nga SFL është cituar se kandidati ka dorëzuar plan-biznesi i cili përmban dhe planin financiar të planifikuar të radios për 3 (tre) vitet e ardhshme, si dhe si garanci të ofruara për aftësinë financiare për të kryer veprimtarinë, kandidati ka dorëzuar gjendjen e llogarisë nga banka komerciale të subjektit juridik – parashtruesi i aplikimit dhe depozitë parash të hapur në fondin e investimeve nga banka komerciale. Aplikanti ka dorëzuar gjithashtu dhe bilancin e gjendjes dhe të dhëna nga bilanci i suksesit për vitet 2023 dhe 2024, nga ku SFL vazhdoi me vlerësimin e mëtejshëm të aplikacionit.

Sektori për mbështetje informatike dhe çështjet të përgjithshme (SMIÇP) në kontributin e dorëzuar më 21.07.2025, ka konstatuar se Aplikimi i kandidati – personit juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup është i rregullt dhe ka vazhduar me vlerësimin e mëtejshëm, përkatësisht në: pikën 6 të tabelës. - Kushtet teknike për prodhimin e programit, në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri nga (SMIÇP) është konstatuar se në pajtim me Formularin nr.2 ku janë plotësuar kushtet teknike për prodhimin e programit, kandidati ka përmbushur kushtet e kërkuara të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio; pika 8 e tabelës - Kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë, në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri nga (SMIÇP), është konstatuar se në pajtim me Formularin nr.2, i cili paraqet edhe kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë, kandidati ka përmbushur kushtet e kërkuara në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe pika 10 e tabelës - Afat i ofruar për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, nga (SMIÇP) është konstatuar se kandidati në Aplikim si afat për fillimin e kryerjes së veprimtarisë ka cekur datën 1.10.2025, që do të thotë deri në 3 (tre) muaj nga dita e dhënies së lejes.

Në bazë të vlerësimit të përfunduar dhe pikëzimit të Aplikacionit për pjesëmarrje në konkursin publik të kandidatit, personit juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup, numri i përgjithshëm i pikëve të dhëna është 85 pikë, siç thuhet në Raportin e Vlerësimit të Aplikacionit të përgatitur nga Agjencia PA1 nr.08-214 datë 4.8.2025 dhe është konstatuar se Aplikimi PA1 nr.08-214 datë 14.7.2025, paraqitur nga kandidati i vetëm, personi juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup, i plotëson kushtet e përcaktuara në konkursin publik në pajtim me Vendimin e Agjencisë për shpallje të konkursi publik, PA1 nr.08-155 datë 8.5.2025 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.96/25 datë 14.5.2025).

Me qëllim që të përcaktohen në mënyrë të drejtë faktet gjatë marrjes së vendimit për dhënien e lejes për transmetim në radio, të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit, përkatësisht për të përcaktuar nëse ekzistojnë pengesa ligjore që parashtruesit të Aplikimit t'i jepet leja për transmetim në radio, Agjencia më 28.7.2025 përmes sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrat Qendror të RMV-së, ka ofruar dokumente nga ku shihet se në cilat shoqëri tregtare paraqitet si themelues/pronarë personi juridik SHTR "BUBA MARA Ranko" SHPKNJP Shkup dhe personi fizik Ranko Petroviq, konkretisht: "Informacion mbi subjektet e lidhura (persona të autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera – gjendja vijuese", nr.0820-50/150020250284398, nr.0820-50/150020250284411 dhe nr.0820-50/150020250284456, të gjitha nga data 28.7.2025, si dhe "Gjendja vijuese për personin fizik - pronar i vërtetë" nr.2007-50/150020250284419 datë 28.7.2025, nga ku është konstatuar se nuk shkelen dispozitat e Kapitullit IV të LSHMAAV

Në lidhje me Raportin e vlerësimit të aplikimit të paraqitur për pjesëmarrje në konkursin publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal PA1 nr.08-214 datë 4.8.2025, personi i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, drejtuar Këshillit të Agjencisë ka paraqitur Propozimin PA1 nr.08-214 datë 5.8.2025, për miratimin e vendimit për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor, në nivel lokal, në rajonin e komunës së Shtipit, kandidatit, personit juridik SHTR BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup, me seli në bulevardin., "Partizanski odredi" nr.62-lamelë C/hyrja në katin e ndërmjetëm 1, komuna Karposh, Shkup.

Në bazë nga sa më sipër, Këshilli i Agjencisë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafi 17 dhe 18 dhe neni 75 të LSHMAAV, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, pas zbatimit të Konkursit Publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, të publikuar në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik, PA1 nr.08-155 datë 08.05.2025 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.91/25 datë 7.5.2025 në pajtim me Raportin e vlerësimit të aplikacionit të paraqitur PA1 nr.08-214 datë 4.8.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3325/2 datë 7.8.2025, në seancën e 7-të mbajtur më 7.8.2025 miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Sasho Stefanovski**

**Këshillë juridike:** Pjesëmarrësi në Konkurs për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, publikuar në bazë të Vendimit PA1 nr.08-155 datë 8.5.2025 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.96/25 datë (14.5.2025), nëse është i pakënaqur me Vendimin, ka të drejtë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit, të paraqesë padi në Gjykatën Administrative të RMV-së.